



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 49

Tiranë – E mërkurë, 25 mars 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 71, datë 25.2.2020	Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2020–2021 në sistemin arsimor parauniversitar..... 3225
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 133, datë 8.3.2020	Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale..... 3225
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 134, datë 8.3.2020	Për vetëkarantinimin e personave që hyjnë në territorin e Shqipërisë nga zona e izoluar në Itali..... 3226
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 135, datë 9.3.2020	Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19..... 3226
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 135/1, datë 9.3.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19..... 3227
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 147, datë 9.3.2020	Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndoroqi” 3227
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 156, datë 10.3.2020	Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19..... 3227
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 157, datë 10.3.2020	Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfituesve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror 3228

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 158, datë 11.3.2020	Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar dhe invaliditetit të punës.....	3229
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 159, datë 11.3.2020	Për kufizimin e lëvizjes së pacientëve, shoqëruesve dhe/ose familjarëve dhe organizimin e shërbimeve në institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryhen vizita dhe konsulta ambulatorie.....	3229
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 160, datë 11.3.2020	Për nderprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në të gjithë strukturat spitalore publike dhe jopublike.....	3230
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 117, datë 3.3.2020	Për një ndryshim në urdhrin nr. 678, datë 17.12.2019, “Për aplikimin <i>on-line</i> të shërbimeve që mund të ofrohen vetëm në Portalin Qeveritar <i>e-Albania</i> , nga data 1.1.2020”.....	3231
Vendim qarkullues i Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 12.3.2020	Për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.....	3232
Vendim qarkullues i Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 12.3.2020	Për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”.....	3232
Vendim qarkullues i Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 12.3.2020	Për një ndryshim në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”...	3233
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 95, datë 3.3.2020	Autorizim i ndihmës shtetërore për zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik.....	3233
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2770, datë 12.3.2020	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i dy fiderave të rinj kabllorë, fideri F9 dhe fideri F10, me izolacion 20 kV, nënstationi i ri 110/20 kV, Plasmasi, Lushnjë”.....	3237
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2771, datë 12.3.2020	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rrjeti shpërndarës 20 kV nga nënstationi 110/20 Kv, Fier i Ri, fiderat 10 deri 12, dhe nënstationi 110/20 kV, Fideri 2, fiderat M1 deri M10”.....	3239



URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 71, datë 25.2.2020

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
VITIT SHKOLLOR 2020–2021
NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, e të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 7, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2020–2021 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

- a) mësimet fillojnë më 14 shtator 2020 dhe mbarojnë më 8 qershor 2021;
- b) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2020 dhe mbarojnë më 4 janar 2021;
- c) provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 9–30 qershor 2021.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

- a) mësimet fillojnë më 14 shtator 2020 dhe mbarojnë më 15 qershor 2021;
- b) për maturat, mësimet fillojnë fillon më 14 shtator 2020 dhe mbarojnë më 1 qershor 2021;
- c) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2020 dhe mbarojnë më 4 janar 2021;
- ç) provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2–30 qershor 2021.

3. Në arsimin profesional:

- a) mësimet fillojnë më 14 shtator 2020;
- b) nxënësit e klasave të 10-ta, për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta, për strukturën 2+2, si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 4-vjeçare, përfundojnë mësimet më 15 qershor 2021;
- c) nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta, për strukturën 2+1+1 dhe nxënësit e klasave të 11-ta, për strukturën 2+2, përfundojnë mësimet më 1 qershor 2021;
- ç) për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor përfundon më 25 maj 2021;

d) pushimet fillojnë më 24 dhjetor 2020 dhe mbarojnë më 4 janar 2021;

dh) provimet përfundimtare të nivelit I dhe II zhvillohen në periudhën 1–15 qershor 2021;

e) provimi përfundimtar i praktikës profesionale të nivelit III zhvillohet në periudhën 26 maj–1 qershor 2021;

f) provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 2–30 qershor 2021.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

MINISTËR I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 133, datë 8.3.2020

PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES SË
SHOQËRUESVE DHE/OSE
FAMILJARËVE TË PACIENTËVE
NËPËR SPITALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Koronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,



URDHËROJ:

1. Në ambientet e shërbimeve të urgjencës mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve, me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore.

2. Në ambientet e shërbimit spitalor, ku janë duke marrë trajtimin spitalor pacientët, ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve, me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri strukturat shëndetësore të urgjencave mjekësore dhe atyre spitalore, si dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 134, datë 8.3.2020

**PËR VETËKARANTINIMIN E
PERSONAVE QË HYJNË NË
TERRITORIN E SHQIPËRISË NGA
ZONA E IZOLUAR NË ITALI**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 dhe nenit 17, germa “dh”, e ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Të gjithë shtetasit që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vijnë nga zona e izoluar në Itali, të vetëkarantinohen për një periudhë 14-ditore në ambientet e banesave të tyre, si një masë parandaluese për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

2. Strukturat shëndetësore të sigurojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme të të gjithë personave

të identifikuar si persona që kanë hyrë në vendin tonë nga zona e izoluar në Itali.

3. Moszbatimi i këtij urdhri nga personat që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, nga zona e izoluar në Itali, është i dënueshëm sipas dispozitave të nenit 35, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjitha strukturat përgjegjëse shëndetësore në të gjithë zonat ku janë personat e vetëkarantinuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 135, datë 9.3.2020

**PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PËR PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 9.3.2020, të Komitetit të Përkohshëm “Për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe të propozimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike, për një periudhë 2 (dy) javore nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

**URDHËR****Nr. 135/1, datë 9.3.2020**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E
PËRHAPJES SË INFEKSIONIT COVID-19**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, germa “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik nr. 395, datë 8.3.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e çerdheve në të gjithë vendin për një periudhë 2-javore.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, i cili bashkëpunon me Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR**Nr. 147, datë 9.3.2020**

**PËR NDERPRERJEN E NDËRHYRJEVE
KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË
QENDRËN SPITALORE
UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”
DHE SPITALIN UNIVERSITAR
“SHEFQET NDRUQI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020, të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga

Coronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit nr. 395, datë 8.3.2020, të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, deri në datën 3 prill 2020.

2. Përfshirjen nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëjnë vetëm ndërhyrjet kirurgjikale për patologjitë malinje, të cilat do zhvillohen sipas planifikimit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR**Nr. 156, datë 10.3.2020**

**PËR MARRJEN E MASAVE TË
VEÇANTA NË PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË
SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në zbatim të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si dhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës, me propozim të Komitetit të Ekspertëve dhe Institutit të Shëndetit Publik

URDHËROJ:

1. Mbylljen për publikun deri në datën 3.4.2020 të:

a) ambienteve që ofrojnë shërbim lokale nate;

b) ambienteve të mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjtë, aktivitetëve në



palestra, qendra sportive, pishina, qendra interneti, qendra kulturore, dhe qendra argëtimi.

2. Ndalimin deri në datën 3.4.2020 të:

a) aktiviteteve sportive, sociale dhe kulturore;

b) ekskursioneve mësimore të organizuara prej institucioneve shkollore me destinacion brenda ose jashtë vendit;

c) procedurave të konkursit për punësim personeli, konkurse shkolli dhe specializimi.

3. Gjatë ditës, aktivitetet e bareve, restoranteve, lokaleve të ofrojnë shërbim për klientët duke respektuar distancën prej së paku dy metrash ndërmjet tavolinave në vendet ulur dhe në çdo rast të garantojnë distancën prej së paku një metër të njeriut nga njeriu.

4. Institucionet publike dhe private, të hartojnë sipas fushës së përgjegjësisë së tyre, brenda datës 11.3.2020, një plan masash për sigurimin e ofrimit të shërbimeve prioritare, duke prioritetizuar kategorinë e shërbimit kryesisht nëpërmjet ofrimit të shërbimit *online*, punës në distancë dhe vetëm në raste të domosdoshme të ofrojnë shërbimin nëpërmjet kontaktit fizik. Për shërbimet për të cilat nevojitet kontakti i drejtpërdrejtë me publikun institucionet duhet të pajisin punonjësit me mjete pune mbrojtëse me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre. Institucionet publike që ofrojnë shërbime pritjeje për publikun në sportel të marrin masa për të shfrytëzuar maksimalisht shërbimet *online* dhe platformën *e-Albania*.

5. Për shërbimet publike për të cilat kërkohet kontakt i afërt me publikun, institucionet duhet të pajisin punonjësit me mjete mbrojtëse, me qëllim ruajtjen e shëndetit të tyre.

6. Organet e shërbimit postar duhet të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit dhe të hartojnë një plan masash për të kufizuar kontaktet e punonjësve me publikun dhe për të shmangur grumbullimin e publikut në sportele apo ambiente të tjera të brendshme.

7. Detyrohen të gjithë personat që kanë hyrë në Shqipëri nga zonat me rrezik epidemiologjik, të identifikuar si të tilla prej Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të plotësojnë skedën e udhëtarit në pikat hyrëse kufitare dhe të vetëkarantinohen detyrimisht për një periudhë 14-ditore, nga datat e hyrjes në kufi.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik, Operatori i Shërbimeve të

Kujdesit Shëndetësor, njësitë e qeverisjes lokale, institucionet publike dhe private të përfshira në këtë urdhër.

12. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor organizon punën me strukturat e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij urdhri dhe merr masa administrative sipas legjislacionit në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet deri në datën 3.4.2020.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 157, datë 10.3.2020

PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKTIMIT NGA COVID-19 TË PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Mbështetur në nenin 116, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Në institucionet e përkujdesit shoqëror pezullohen/ndalohen vizitat nga të afërm dhe familjarë. Në raste specifike vizitat mund të lejohen vetëm me miratimin e titullarit të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Institucionet e përkujdesit shoqëror të marrin masa të shtuara higjieno-sanitare, deri në dezinfektimin e ambientit nëse kjo do të rekomandohet nga strukturat përgjegjëse.

3. Të gjitha njësitë vendore të kujdesit shëndetësor të vendosin kontakte me drejtuesit/mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror, rezidencial



dhe ditor, publik dhe jopublik dhe të monitorojnë situatën shëndetësore të përfituesve që marrin shërbim pranë këtyre institucioneve dhe personelit të institucionit.

4. Mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të kujdesit shoqëror, rezidencial dhe ditor, publik dhe jopublik, të raportojnë në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror mbi monitorimin e procesit në këto institucione.

5. Mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të kujdesit shoqëror rezidencial dhe ditor, publik dhe jopublik, për çdo rast të dyshuar ndjekin protokollet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, të cilët duhet të bashkërendojnë punën me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 158, datë 11.3.2020

**PËR PEZULLIMIN E FUNKSIONIMIT
TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR
DHE INVALIDITETIT TË PUNËS**

Mbështetur në nenin 116, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e shqyrtimit të ankesave nga komisionet eprore mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të cilat funksionojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror.

2. Pezullimin e funksionimit të Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, dhe Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, pranë të cilave paraqiten individë për vlerësim/rivlerësim.

3. Pezullimi i funksionimit të komisioneve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri bëhet deri më datë 3 prill 2020.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 159, datë 11.3.2020

**PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES SË
PACIENTËVE, SHOQËRUESVE
DHE/OSE FAMILJARËVE DHE
ORGANIZIMIN E SHËRBIMEVE NË
INSTITUCIONET E KUDJESIT
SHËNDETËSOR KU KRYHEN VIZITA
DHE KONSULTA AMBULATORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe të udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,



URDHËROJ:

1. Në ambientet e brendshme apo strukturat e veçanta të institucioneve të kujdesit shëndetësor, poliklinika e spitale, të sistemit publik dhe jopublik, ku zhvillohen vizita dhe konsulta ambulatorë të merren masa të menjëhershme për ndalimin e grumbullimit të pacientëve dhe organizimin e shërbimit ambulator duke ruajtur perimetrin e sigurisë për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Distanca midis pacientëve dhe ofruesve të shërbimit, duhet të jetë jo më pak se 1.5 metër distancë nga njëri-tjetri.

2. Të ndalohet prezenca e familjarëve apo të afërmeve në mjediset e konsultave, poliklinikave, qendrave shëndetësore me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19.

3. Institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryhen vizita ambulatorë të marrin masa për respektimin e kërkesave të pikës 1 dhe 2 të këtij urdhri.

4. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor organizon punën në institucionet e kujdesit shëndetësor, qendrat shëndetësore, poliklinikat dhe spitalet për të siguruar bazën e shërbimeve të nevojshme bazë për qytetarët duke nxitur përdorimin e shërbimeve *online* dhe platformave *e-Albania* dhe Telemjekësia.

5. Fondi i Sigurimit të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor të marrë masa për nxjerrjen e udhëzimeve për lehtësimin e procedurave dhe përdorimin e sistemeve elektronike në paketën e barnave të rimbursueshme duke krijuar dhe promovuar shërbimet *online*.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, FSDKSH-ja, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, strukturat shëndetësore të kujdesit shëndetësor, si dhe të gjithë spitalet publike dhe private.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 160, datë 11.3.2020

**PËR NDERPRERJEN E NDËRHYRJEVE
KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË
TË GJITHË STRUKTURAT SPITALORE
PUBLIKE DHE JOPUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale të planifikuara në të gjithë strukturat spitalore publike dhe jopublike deri në datën 3 prill 2020.

2. Përfshirjen nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëjnë vetëm ndërhyrjet kirurgjikale për patologjitë malinje, të cilat do zhvillohen sipas planifikimit.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri strukturat spitalore publike dhe jopublike dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



URDHËR
Nr. 117, datë 3.3.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 678, DATË 17.12.2019, “PËR
APLIKIMIN ON-LINE TË SHËRBIMEVE
QË MUND TË OFROHEN VETËM NË
PORTALIN QEVERTAR E-ALBANIA,
NGA DATA 1.1.2020”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 158, datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *on-line*, nga data 1.1.2020”

URDHËROJ:

1. Urdhri i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 678, datë 17.12.2019, “Për aplikimin *on-line* të shërbimeve që mund të ofrohen vetëm në

Portalin Qeveritar *e-Albania*, nga data 1.1.2020”, ndryshon si më poshtë vijon:

- lista e shërbimeve bashkëlidhur urdhrin nr. 678, datë 17.12.2019, zëvendësohet me listën e shërbimeve bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve dhe Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

SHËRBIMET QË MUND TË OFROHEN VETËM NË PORTALIN QEVERTAR
E-ALBANIA, NGA DATA 1.1.2020

Nr.	Institucioni	Titulli	Afati për kalimin vetëm <i>on-line</i>
1	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Aplikim për të fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit/akuakulturës në ujërat e brendshme.	1 janar 2020
2	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Skema Kombëtare e Mbështetjes për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.	1 janar 2020
2.a	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Aplikim për mbështetje financiare për tufën bazë të matrikulluar.	1 janar 2020
2.b	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Aplikim për mbështetje financiare në bletari.	1 janar 2020
2.c	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Aplikim për mbështetje financiare për zëvendësimin e plastmasës termike.	1 janar 2020
2.ç	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Aplikim për mbështetje financiare për mbjelljen e bimëve mjekësore e aromatike.	1 janar 2020
2.d	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Aplikim për mbështetje financiare për fermat organike.	1 janar 2020
2.e	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Aplikim për mbështetje financiare për implementimin dhe certifikimin e Global GAP.	1 janar 2020

Shënim. Titulli i shërbimeve për pikat 2.a deri 2.e mund të ndryshojë çdo vit në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e Skemës Kombëtare të Mbështetjes për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

**VENDIM QARKULLUES**
Nr. 13, datë 12.3.2020**PËR NJË NDRYSHIM NË**
RREGULLOREN “PËR
ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË
KREDISË NGA BANKAT DHE DEGËT
E BANKAVE TË HUAJA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, e ndryshuar, të bëhet shtesa e mëposhtme:

a) shtohet neni 23 me emërtimin “Dispozitë e përkohshme” dhe me përmbajtjen e mëposhtme:

“Pezullimin e zbatimit të kërkesave të kreut III, neni 11 dhe neni 14 i kësaj rregulloreje, për periudhën mars deri maj 2020.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko**VENDIM QARKULLUES**
Nr. 14, datë 12.3.2020**PËR NJË NDRYSHIM NË**
RREGULLOREN “PËR
ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË
VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE
FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 2, datë 17.1.2013, e ndryshuar, të bëhet shtesa e mëposhtme:

a) shtohet neni 40 me emërtimin “Dispozitë e përkohshme” dhe me përmbajtjen e mëposhtme:

“Pezullimin e zbatimit të kërkesave të kreut III, neni 14 dhe neni 15 i kësaj rregulloreje, për periudhën mars deri maj 2020.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko



VENDIM QARKULLUES
Nr. 15, datë 12.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË
RREGULLOREN “PËR
ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË
VEPRIMTARINË E SHOQËRIVE TË
KURSIM-KREDITIT DHE TË
UNIONEVE TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 105, datë 5.10.2016, të bëhet shtesa e mëposhtme:

a) shtohet neni 34 me emërtimin “Dispozitë e përkohshme” dhe me përmbajtjen e mëposhtme:

“Pezullimin e zbatimit të kërkesave të kreut III, neni 14 dhe neni 15 i kësaj rregulloreje, për periudhën mars deri maj 2020.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinën Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 95, datë 3.3.2020

**AUTORIZIM I NDIHMËS
SHTETËRORE PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT
TRANS ADRIATIK**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Anila Denajkryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Znj. Etleva Hakaanëtare;
- Znj. Mirjana Zisianëtare.
- Z. Ahmet Mançellarianëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 3.3.2020, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

I. PROCEDURA

1. Me shkresën nr. 4461, datë 2.10.2019, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të shkronjës “g”, pika 2.1, “Data e hyrjes në fuqi”, të ligjit nr. 53/2017 “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës”, paraqiti kërkesën për marrjen e Autorizimit të Ndhmës Shtetërore pranë Komisionit të Ndhmës shtetërore.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

2. Në bazë të shkronjës “d”, të ligjit nr. 116/2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti Tap)”, është parashikuar se:

“Pavarësisht sa më sipër, Palët kanë vijuar me nënshkrimin e MQP-së dhe Shteti do të vijojë më tej me ratifikimin e MQP-së nga Parlamenti Shqiptar, duke marrë në konsideratë faktin që nëse do të jetë e nevojshme, MQP-ja do të ndryshohet nga Palët në përputhje me këtë



Marrëveshje, me qëllim përafrimin e saj me MQP-në e Greqisë për sa u përket çështjeve specifike financiare”.

3. Në përputhje me shkronjën “g”, pika 2.1, “Data e hyrjes në fuqi”, të ligjit nr. 53/2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës”, kërkohet autorizimi i Komisionit të Ndihmës Shtetërore, me qëllim hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së ndryshimit.

4. Qëllimi i Marrëveshjes së ndryshimit është zbatimi i detyrimeve të Palëve, sipas Marrëveshjes krahasuese në lidhje me ndryshimet e kërkuara.

III. BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 116, datë 15.4.2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”.

- Ligji nr. 53/2017 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës.

IV. KOHËZGJATJA

Në bazë të pikës 7, të shtojcës 1, “Ndryshimet në Marrëveshjen me Qeverinë Pritëse”, të ligjit nr. 53/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës”, është përcaktuar se:

“Neni 24.5 hiqet dhe nenet e përcaktuara më poshtë shtohen si nene 24.5–24.8 të MQP-së, dhe paragrafët e tjerë brenda nenit 24 (Taksat) (dhe çdo referim tjetër në MQP tek ato nene) rinumërohen përkatësisht.

Zbatimi tek Investitori i Projektit

24.5 Në bazë të Nenit 24.6 dhe përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe ose lejohet nga kjo Marrëveshje, ligji i Taksave të Shtetit:

a. në fuqi në Datën e Nënshkrimit, përveç në lidhje me normën e TVSH-së (Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit) do të jetë i vlefshëm dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit deri më dhe duke përfshirë Datën DOT, të Vitit të Dhjetë;

b. në fuqi në datën pas Datës DOT, të Vitit të Dhjetë, përveç në lidhje me Normën e TVSH-së (Kodi i Taksave të Periudhës së Dytë) do të jetë e vlefshme dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit nga dita e nesërme e Datës DOT, të Vitit të Dhjetë, deri më dhe duke përfshirë Datën DOT, të Vitit të Njëzetë (Periudha e Dytë e Taksave); dhe

c. në fuqi në ditën e nesërme pas Datës DOT, të Vitit të Njëzetë, përveç në lidhje me normën e TVSH-së (Kodi i Taksave të Periudhës së Tretë), do të jetë e vlefshme dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit nga dita e nesërme e Datës DOT, të Vitit të Njëzetë, deri dhe duke përfshirë Datën DOT, të Vitit të Njëzetë e Pestë (Periudha e Tretë e Taksave), në secilin rast, duke përjashtuar të gjitha Taksat e tjera gjatë periudhës përkatëse.

Sa më lart kohëzgjatja e zbatimit të Marrëveshjes së Ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës, të miratuar me ligjin nr. 17/2017, do të jetë 25 vite nga fillimi i operacioneve tregtare.

V. FORMA E MBËSHTETJES

Në bazë të 7, të shtojcës 1, “Ndryshimet në Marrëveshjen me Qeverinë Pritëse”, të ligjit nr. 53/2017, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës”, është përcaktuar se:

- 24.7. Për çdo vit të Periudhës së Dytë të Taksave:

a) Investitori i Projektit duhet që brenda 30 ditësh pas depozitimit të deklarimit të të ardhurave vjetore në lidhje me vitin përkatës, të pajisë Shtetin me një raport ku përcaktohen:



i. të gjitha taksat që janë paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti në përputhje me Kodin e Taksave të Periudhës së Dytë (Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë);

ii. të gjitha taksat që duhet të ishin paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti, nëse Kodi i taksave të Datës së Nënshkrimit do të ishte hartuar (Shuma SD e Periudhës së Dytë); dhe

iii. një krahasim midis Shumës së Paguar të Periudhës së Dytë dhe Shumës SD të Periudhës së Dytë; dhe

b) nëse në lidhje me vitin përkatës:

i. Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë është më pak se Shuma SD e Periudhës së Dytë, me më shumë se 5.2 % të SD, Investitori i Projektit duhet t'i paguajë Shtetit shumën që është në kalim të kufirit 5.2 %, brenda 60 ditësh nga data e raportit të Investitorit të Projektit, sipas nenit 24.7(a); ose

ii. Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë është më e madhe se Shuma SD e Paguar e Periudhës së Dytë, me më shumë se 5.2 % të të Ardhurave të Tatueshme SD, Shteti duhet t'i paguajë Investitorit të Projektit shumën që është në kalim të kufirit 5.2 % brenda 60 ditësh nga data e raportit të Investitorit të Projektit, sipas nenit 24.7(a).

- 24.8. Për secilin vit të Periudhës së Tretë të Taksave:

a) Investitori i Projektit duhet që brenda 30 ditësh pas depozitimit të deklarimit të të ardhurave vjetore në lidhje me vitin përkatës, të pajisë Shtetin me një raport ku përcaktohen:

i. të gjitha taksat që janë paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti në përputhje me Kodin e Taksave të Periudhës së Tretë (Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë);

ii. të gjitha taksat që duhet të ishin paguar nga Selia e Përhershme në Shtet gjatë atij viti, nëse Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit do të ishte hartuar (Shuma SD e Periudhës së Tretë); dhe

iii. një krahasim midis Shumës së Paguar të Periudhës së Tretë dhe Shumës SD të Periudhës së Tretë; dhe

b) nëse në lidhje me vitin përkatës:

i) Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë është më pak se Shuma SD e Periudhës së Tretë me më shumë se 5.2% të të Ardhurave të Tatueshme

SD, Investitori i Projektit duhet t'i paguajë Shtetit shumën që është në kalim të kufirit 5.2%, brenda 60 ditëve nga data e raportit të Investitorit të Projektit, sipas nenit 24.8(a); ose

ii) Shuma e Paguar e Periudhës së Tretë është më e madhe se Shuma SD e Paguar e Periudhës së Tretë me më shumë se 5.2% të të Ardhurave të Tatueshme SD, Shteti duhet t'i paguajë Investitorit të Projektit shumën që është në kalim të kufirit 5.2%, brenda 60 ditëve nga data e raportit të Investitorit të Projektit, sipas nenit 24.8(a).

Sa më lart, kushtet e zbatimit të skemës së normës së tatimit mbi fitimin janë dakordësuar në Marrëveshjen e Ndryshimit për të “ngrirë” dispozitat e Marrëveshjes për periudhën e zbatimit të projektit në tri periudha kohore:

1. Ligji i Taksave të Shtetit në fuqi në Datën e Nënshkrimit, përveç në lidhje me normën e TVSH-së (Kodi i Taksave të Datës së Nënshkrimit) do të jetë i vlefshëm dhe do të zbatohet tek Investitori i Projektit deri më dhe duke përfshirë Datën e DOT të Vitit të Dhjetë.

2. Midis vitit të 10-të dhe vitit të 20-të të kohës së operacioneve tregtare, do të konsiderohet si **Periudha e Dytë e Taksave**. Megjithatë nëse në secilën prej ndonjërës prej këtyre viteve, Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë është më pak se Shuma SD e Periudhës së Dytë me më shumë se 5.2 % të SD, Investitori i Projektit duhet t'i paguajë Shtetit shumën që është në kalim të kufirit 5.2 % dhe nëse Shuma e Paguar e Periudhës së Dytë është më e madhe se Shuma SD e Paguar e Periudhës së Dytë me më shumë se 5.2 % të të Ardhurave të Tatueshme SD, Shteti duhet t'i paguajë Investitorit të Projektit shumën që është në kalim të kufirit 5.2 %.

3. Midis vitit të 20-të dhe vitit të 25-të të kohës së ushtrimit të aktivitetit ekonomik, do të konsiderohet si **Periudha e Tretë e Taksave**. Megjithatë nëse në secilën prej ndonjërës prej këtyre viteve, norma e tatimit mbi të ardhurat që paguhet do të jetë 5.2 më e lartë apo 5.2 % më e ulët se shuma e tatimit që duhet të ishte paguar, duhet të kryhet një pagesë (si shteti ndaj investitorit apo investitori ndaj shtetit). Pra diferenca zbret në 5.2 %.

Pra, për **Periudhën e Dytë dhe të Tretë të Taksave**, norma e tatimit mbi të ardhurat që



paguhet do të jetë 5.2% më e lartë, apo 5.2% më e ulët, se shumta e tatimit që duhet të ishte paguar, duke u kryer një pagesë (shteti ndaj investitorit apo investitori ndaj shtetit). Pra diferenca zbret në 5.2 %.

VI. VLERËSIMI

1. Ekzistenca e ndihmës shtetërore

1. Neni 4, i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar parashikon se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”

2. Mbështetur në marrëveshjen e ndryshimit, TAP-i mund të vazhdojë të paguajë normën e tatimit të fitimit në fuqi që prej fillimit të operimit të gazsjellësit sipas një skenari kur norma e tatimitfitimit të jetë rritur, duke rezultuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Në këtë mënyrë skema e regjimit fiskal të tatimit mbi fitimin të parashikuar në ligjin nr. 53/2017 financohet, nga burimet e shtetit.

3. Skema e regjimit fiskal të tatimit mbi fitimin të parashikuar në ligjin nr. 53/2017, i ofron TAP-it një avantazh, i cili konsiston në mundësinë e zgjedhjes së një regjimi të qëndrueshëm tatimor për një periudhë të paracaktuar brenda kufijve të caktuar. Skema nuk ofrohet për ndërmarrjet e tjera, prandaj masa është selektive.

4. Masa gjithashtu kërcënon të shtrembërojë konkurrencën dhe ka potencial të ndikojë në tregti, pasi lidhet me funksionimin e një linje të transmetimit ndërkufitar të gazit natyror midis tre shteteve të rajonit.

Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se skema e ndihmës shtetërore për zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adriatik, përfshihet në rastet e parashikuara ndryshe në këtë ligj, dhe përbën ndihmë shtetërore, e cila është e lejueshme në bazë të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

2. Përputhshmëria me nenin 13 (b), të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar

Komisioni konsideron se vlerësimi i përputhshmërisë së masës kërkon një vlerësim të kontributit të projektit në zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri, dhe për këtë arsye duhet të bazohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenin 13, shkronja “b”, të ligjit për ndihmën shtetërore nr. 9379/2005, i cili parashikon se ndihma mund të lejohet nëse “nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë ose jepet për të mënjeluar situata të rënda në ekonominë e Republikës së Shqipërisë”, sepse:

- projekti do të kontribuojë në diversifikimin e mëtejshëm të burimeve të furnizimit me energji, duke transportuar gaz nga rajoni i Detit Kaspik drejt perëndimit;

- konkurrenca në tregun rajonal të gazit do të rritet për shkak të ofertës së shtuar të gazit dhe rrugës së re të transmetimit;

- ndërtimi i gazsjellësit kërkon investime të konsiderueshme gjatë disa viteve përpara se të gjenerohen të ardhura. Projekti do të financohet tërësisht nga investimet private dhe do të gjenerojë të ardhura në Shqipëri, nga tarifat e paguara nga klientët që do të transportojnë gaz në tubacion;

- ndihma është në formën e një regjimi specifik tatimor që, varësisht nëse niveli i taksave rritet ose ulët, do të bëjë që TAP-i të paguajë më shumë ose më pak taksa sesa do të paguante pa ndihmën shtetërore. Nëse norma e tatimit mbi fitimin rritet, ndihma do të kufizohet në përfitimin minimal tatimor për TAP-in;

- objektivi kryesor i ndihmës është zhvillimi i sistemit të transmetimit të gazit dhe ndërlidhja e saj me vendet e rajonit, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës bazë për funksionimin e tregut të brendshëm të gazit në Shqipëri dhe në rajon.

Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se masa e ndihmës, e cila mbështet ndërtimin e gazsjellësit Trans Adriatik, një projekt i cili kontribuon në realizimin e interkoneksionit të gazit të prodhuar në Shah Denis II, Azerbajxhan për t'u shpërndarë dhe avancuar nëpërmjet Greqisë drejt Italisë dhe vendeve të tjera të Evropës, nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët në një mënyrë të nevojshme dhe proporcionale dhe për këtë arsye është në



përputhje me nenin 13, shkronja “b”, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore për zbatimin e projektit të gazsjellësit Trans Adreatik (projekti TAP), të parashikuar në ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti Tap), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, mbështetur në nenin 13, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë.

2. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të monitorojë zbatimin e skemës së tatimit mbi fitimin për TAP AG, për të siguruar që ndihma është e kufizuar në minimumin e nevojshëm dhe të njoftojë pranë Komisionit të Ndihmës Shtetërore çdo ndryshim të skemës së njoftuar.

3. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Anila Denaj

KËRKESË

Nr. 2770, datë 12.3.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i dy fiderave të rinj kabllorë, fideri F9 dhe fideri F10, me izolacion 20 kV, nënstationi i ri 110/20 kV, Plasmasi, Lushnjë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është OSHEE sh.a.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, personat e tretë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e plotësimit të afateve të publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 26,407.92 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOJEN NGA PROJEKTI:
 “NDËRTIMI I DY FIDERAVE TË RINJ KABLORE FIDERI F9 DHE FIDERI F10 ME IZOLACION 20 KV, NËN STACIONI I RI 110/20 KV, PLASMASI, LUSHNJË”

Nr.	Numri i Kabines	Te dhena per pronesine							Sip.e prekur nga Shprosesimi per Kabinen m ²	Cmimi Lek/m2	Vlera e Shprosesimit ne Leke per Kabinë	Shenime
		Emri	Atesia	Mbitemri	Zona Kadastral	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Sip. e prones m ²				
BUSHRIE, KARBUNARE ZONA KADASTRALE 2087												
1	1				2087				9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
2	2				2087				9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
3	3	Shtet			2087	651/41	Rrugë	1823	9.24			Konfirmuar ZVRPP
4	4				2087	1076			9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
5	5	Bashkim	Elmaz	Kasapi	2087	639/5	Arë+Truall	1700	9.24	364	3363.36	Konfirmuar ZVRPP
6	6	Izet	Tofil	Kasapi	2087	635/46	Truall	1800	9.24	2130	19681.2	Konfirmuar ZVRPP
7	7	Shtet			2087	618/56	Rrugë	6500	9.24			Konfirmuar ZVRPP
8	8				2087	910			9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
9	9	Shtet			2087	1025	Kanal	27300	9.24			Konfirmuar ZVRPP
10	10	Shtet			2087	557/43	Përrua	4800	9.24			Konfirmuar ZVRPP
11	11	Shtet			2087	378/14	Kabinë elektrike	16	9.24			Konfirmuar ZVRPP
12	12	Shtet			2087	374/14	Truall	5875	9.24			Konfirmuar ZVRPP
13	13	Shtet			2087	583/18	Rrugë	2000	9.24			Konfirmuar ZVRPP
14	14	Shtet			2087	573/33	Truall	5875	9.24			Konfirmuar ZVRPP
15	15	Shtet			2087	623/5	Arë	3438	9.24			Konfirmuar ZVRPP
16	16	Shtet			2087	647/3	Arë	4625	9.24			Konfirmuar ZVRPP
17	17	Letif	Nurce	Shakaj	2087	617/7	Arë+Truall	750	9.24	364	3363.36	Konfirmuar ZVRPP
18	18				2087				9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
19	19				2087				9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
20	20				2087	24/156			9.24			Konfirmuar nga ZVRPP, pasuria figuron e pa regjistruar
21	21	Shtet			2087	607/58	Truall	8600	9.24			Konfirmuar ZVRPP
Total paraprak i Shprosesimit											26,407.92	

**KËRKESË****Nr. 2771, datë 12.3.2020****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rrjeti shpërndarës 20 kV nga nënstacioni 110/20 Kv, Fier i Ri, fiderat 10 deri 12, dhe nënstacioni 110/20 kV, Fideri 2, fiderat M1 deri M10”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Me anë të këtij publikimi, kërkohet të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim

për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në Vendimin Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **1 382 390.31 (një milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë pikë tridhjetë e një) lekë.**

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA E PRONARËVE OË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË PROJEKTTI "RRJETI SHPERNDARËS 20 KV NGA NËNSTACIONI 110/20 KV FIER I RI, FIDERAT 10 DERI 12 DHE NËNSTACIONI 110/20 KV FIDERI 2 FIDERAT M1 DERI M10

Qarku: Fier; Bashkia Fier

Lloji i pasurisë së palujtshme që shpronësohet: Tokë 'Arë' dhe 'Truall'

Nr.	Numri i Kabinës	Të dhëna për pronësinë			Zona Kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip. pronës m ²	Sip. që shpronësohet	Çmimi Lek/m ²	Vlera e Shpronësimit në Lekë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri								
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
FIER, DRIZE, ZONA KADASTRALE 1557												
1	K01/12	Shtet			1557	262/42	Rruge	1468	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
2	K01/12	Dhimitraq	Qendro	Shaka	1557	262/73	Are	280	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
3	K01/12	Shtet			1557	262/76	are	157	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
FIER,MBYET ZONA KADASTRALE 2637												
4	K01/11	Naile	Adem	Tahiri	2637	72/1	Are	1000	9.87	269	2655.03	Konfirmuar nga ZVRPP, ka shënimin "pa certifikate pronësie"
5	K04/10	Bylyre	Cobo	Bushi	2637	62/26	Are	5936	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP, ka shënimin "pa certifikate pronësie"
6	K04/10	Ymer	Sefer	Bushi	2637	62/27	Are	2852	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
FIER,QYTET ZONA KADASTRALE 8532												
7	K04/11	Bashke pronare Prifti			8532	7/494	Truall	350	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
8	K04/11	Shtet			8532	7/495	Truall	191	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
FIER,QYTET ZONA KADASTRALE 8531												
9	K05/10	Erion	Haki	Shehaj	8531	9/481	Truall	300	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
10	K05/10	Shtet			8531	9/482	Truall	1225.89	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
FIER,SHEQ I MADH ZONA KADASTRALE 3981												
11	K01/M3	Pandeli	Dudi	Kola	3981	115/1	ARE	650	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
12	K02/M3	Aleks	Miti	Llazi	3981	115/16	ARE	3983	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
13	K02/M3	SHTET			3981	115/35	RRUGJE	1927				Konfirmuar nga ZVRPP
14	K05/M4	Astrit	Park	Hoxhaj	3981	68/1	ARE	2000	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
15	K07/M3	Aleksander	Petraq	Doko	3981	183/161	ARE	1677	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
16	K07/M3	Leonard	Petraq	Doko	3981	183/162	ARE	1677	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
17	K08/M3	Agron	Miti	Prifti	3981	183/4	ARE	2760	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
18	K10/M3	Ferdinand	Skender	Perko	3981	154/22	ARE	12014	9.24	269	2485.56	Konfirmuar nga ZVRPP
19	K04/M3	Shtet			3981	117/36	Rruge	1455	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
20	K04/M3	Shtet			3981	430	Kanal	2532	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
FIER ZONA KADASTRALE 8532												
21	02/M6	Ferrik	Refat	Avdiaj	8532	9/737	Truall	246.21	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
22	02/M6	Pronar i pavartetuar			8532	9/738	Truall	246.1	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
23	K07/M4	Elsa	Selim	Baqi	8532	3/655	Truall	194	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
24	K07/M4	Shtet			8532	3/656	Truall	1544	9.24			
25	K06/M6	Widon Tare Nivila Blerta Tajar Hoxhaj			8532	1/873	Truall	750	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
26	K01/M2	OSHELH			8532	8/535	KE	9.07				
27	K01/M2	Pronar i pavartetuar			8532	8/536	truall	176.3	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
28	K02/M2	Thumi	Koli	Prifti	8532	8/528	truall	200	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga Zvrpp
29	K02/M2	Pronar i pavartetuar			8532	8/529	truall	194	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga Zvrpp



Nr.	Numri i Kabinës	Të dhëna për pronësinë							Sip. që shpronësohet	Çmimi Lek/m²	Vlera e Shpronësimit në Lekë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip. pronës m²				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
30	K03/M2	Shtet			8532	8/186	rrugë	12484	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
31	K08/M4	Pronar i pavetëruar			8532	2/89	truall	2528	9.24	12458	115111.92	Konfirmuar nga ZVRPP
FIK ZONA KADASTRALE 8533												
32	K09/M6	Qani	Maksut	Dika	8533	2/293	Truall	100	9.24	11026	101880.24	Konfirmuar nga ZVRPP
33	K09/M6	Omer	Maksut	Dika	8533	2/292	Truall	100	9.24	11026	101880.24	Konfirmuar nga ZVRPP
34	K05/M6	Shtet			8533	2/264	truall	8752	9.24			Konfirmuar nga ZVRPP
Total Shpronësimit									213.15		1,382,190.31	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë